

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	NATO-ja rrëzon një dron mbi Lituani, Danimarkës i sulmohet një helikopter
ADRESA	https://www.koha.net/bote/nato-ja-rrezon-nje-dron-mbi-lituani-danimarkes-i-sulmohet-nje-helikopter
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 01:58:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f79ef2c323374e4be5427ecbf6bc7963c621b36a2c2995732dc825a167e6835e
TEKSTI	64414fc6435047f4765006a91ff97949d9f201885d943a2dde595e85cc600ebd
PAMJA	410006fc405568de0e703de98bd6bf63747ef7fee7b8c328c3dde7eaaee050a0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d6e8bb87ba2039278db6ac8c83197ea220c1e6f5b4ddcebb800bfdce68da244e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b76c045c30cbbea9eae7a42cd456659a809b623ad6b8382f688578771e275bcf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d6e8bb87ba2039278db6ac8c83197ea220c1e6f5b4ddcebb800bfdce68da244e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

NATO-ja rrëzon një dron mbi Lituani, Danimarkës i sulmohet një helikopter



Foto: Associated Press

Përktheu: Flutura Gashi-Mehmeti



15 shtator 2026 15:56

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Avionët luftarakë të NATO-s kanë rrëzuar një dron që kishte hyrë në hapësirën ajrore të Lituanië gjatë natës të së hënës, kanë bërë të ditur zyrtarët e aleancës.

Njoftimi u bë një ditë pasi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se goditjet pranë territorit të aleancës do ta shtyjë organizatën transatlantike të rrisë mbështetjen për Kievën.

Droni është rrëzuar në një fshat rreth 100 kilometra në perëndim të kryeqytetit të vendit, Vilnius, dhe pranë rezervuarit të Kaunasit, ka njoftuar të martën Qendra Kombëtare e Menaxhimit të Krizave të Lituanië.

Ushtria lituaneze ka thënë se incidenti shënon herën e parë që një dron është rrëzuar në hapësirën ajrore të vendit.

Ndërkaq kryeministri i Lituanië, Mindaugas Sinkevičius, ka deklaruar se veprimet tregojnë që vendi i tij duhet të shtojë mbrojtjen ajrore.

Edhe



Botë • 15 s. më parë

Avionët luftarakë të NATO-s rrëzojnë një dron që hyri në hapësirën ajrore të Lituanië

“Është e qartë se mbrojtja ajrore po bëhet një çështje gjithnjë e më e rëndësishme edhe në Lituani, jo vetëm në Ukrainë, e cila po mbron veten. Prandaj, sigurisht që do të na duhet të bëjmë përparim së bashku me forcat tona të armatosura dhe t'i bashkojmë përpjekjet tona, në mënyrë që të mund të mbrojmë hapësirën ajrore të vendit tonë”, ka deklaruar Sinkevičius

Ai ka shtuar se kishte informuar aleatët dhe partnerët mbi situatën, si brenda Bashkimit Evropian, ashtu edhe në NATO.

Kërcënimi nga dronët ka qenë vazhdimisht i pranishëm në qiellin e Lituanië, e cila kufizohet me Bjellorusinë, një aleate e

Futboll.

Espí e shpëton Realin nga turpi

Arbëri.

Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

Arbëri.

Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

Futboll.

Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

Kulturë.

“Lufta nën akuzë...” demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

Futboll.

Liverpooi eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

rëndësishme e Moskës, si dhe me enklavën ruse të Kaliningradit.

Ndërkohë, në një tjetër përballje mes forcave ruse dhe atyre të NATO-s të martën, ministria e Jashtme e Danimarkës ka thënë se një helikopter i forcave ajrore daneze ishte qëlluar me fishekzjarrë sinjalizues gjatë filmimit rutinor të një fregate ruse në ujërat pranë portit të Gedserit, në Detin Baltik.

Ministria e Jashtme e Danimarkës ka shkruar në X se kjo është plotësisht e papranueshme, duke shtuar se ambasadori rus ishte thirrur për të dhënë shpjegime lidhur me incidentin.

Por Rusia ka akuzuar helikopterët ushtarakë danezë për kryerjen e manovrave të rrezikshme pranë anijeve të saj luftarake në Detin Baltik dhe i ka dorëzuar një notë zyrtare Kopenhagës për t'u ankuar lidhur me incidente të tilla, ka bërë të ditur më pas ambasadori rus në Danimarkë, Vladimir Barbin, ka shkruar agjencia shtetërore ruse e lajmeve RIA.

Sulmet me dronë nga Rusia kanë vazhduar në të gjithë Ukrainën, pas një postimi të presidentit amerikan, Donald Trump, në rrjetet sociale të hënën, në të cilin ai tha se Rusia dhe Ukraina kishin rënë dakord “të mos godasin” infrastrukturën energjetike të njëra-tjetrës.

Edhe



Botë • 20 maj 2026
Udhëheqësit lituanë nxituan drejt bunkerëve ndërsa një dron shkeli hapësirën ajrore të vendit

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka thënë të hënën vonë se Kievi ishte “i gatshëm të mbështesë de-përshkallëzimin”, nëse Shtetet e Bashkuara mund të siguronin se “Rusia është vërtet e gatshme ta ndalë këtë luftë”.

Por Zelensky ka thënë në një deklaratë të martën se Moska kishte vazhduar të sulmonte sektorin energjetik të Ukrainës, logjistikën dhe infrastrukturën kritike, ndërsa Kievi ishte kundërpërgjigjur duke goditur një rafineri naftë në Syzran, qytet në perëndim të Rusisë.

- #NATO
- #LUFTA NE UKRAINE
- #RUSIA
- #SULMET
- #TENSIONE
- #LITUANI
- #DANIMARKE

Artikuj të ngjashëm



Botë • 19 maj 2026
Estonia rrëzon një dron ukrainas, Ukraina akuzon Rusinë për “luftë elektronike”



Botë • 7 maj 2026
Rrëzohen në Letoni dy dronë rusë, dëmtojnë objektin e magazinimit të naftës



Botë • 2 sht 2026
BE-ja dhe NATO-ja dënojnë sulmin rus me dron, Berlini heton raste të reja sabotimi

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.